



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:015464

Datë: 03.08.2018

Numri i dokumentit: 00096531

P.nr.519/16

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lenden penale sipas P.Th.nga Prizreni Aktakuzës **PP.nr.1290-6/16 e dt.04.07.2016**, kundër të akuzuarit A.A nga fsh.R Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358, par.1 të KP-së, në prezencë të prokurorit të PTH-së nga Prizreni Mehreme Hoxha, dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit Gjyqësor, të mbajtur me dt.26.07.2018, mori publikisht shpallin dhe me datë 03.08.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, A.A nga i ati A e ema A, i lindur me dt. 01.03.1996 ne R. Komuna Shtime ku dhe tani jeton, me numer personal..... i pa martuar, ka te kryer shkollen e mesme, i pa pune, i gjendjes se dobet ekonomike, i pa denuar me pare, shqiptar shtetas i Republikes se Kosoves.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt.02.04.2016, rreth orës 13:50 minuta, në vendin e quajtur “A. e L.”,-K., Njesia Ekonomike Pyjore “C.”, me qellim të vjedhjes pret me motor sharrë drunj të llojit “shkozë”, me diameter prej 10-08 cm, të gjata 09, me vëllim për një dru 0.03 metër kub, me vëllim të përgjithshëm 2.52 metër kub, drunj të llojit “Ahu”, me diametër 10-08 cm, të gjata 09 metër me vëllim të përgjithshëm 0.96 metër kub, që ne total janë 3.48 metër kub, me qrast të dëmtuarës, në shumë prej 532.44 E.

Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358, par. 1, të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 51, 52, 73,74 KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 365 KPK-ës të akuzuarit, i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej dy (2) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari ne afat prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen vepra tjera penale.

I akuzuari lirohet prej shpenzimeve te procedurës konform nenit 453 par. 4 te KPP-së.

Udhëzohet pala e dëmtuar, Përfaqësusi i Drejtorisë për planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari te Komunës së Suharekës qe kërkesën pasurore-juridike ta realizoje ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze **PP.nr. 1290-6/16 e dt.04.07.2016**, e ka akuzuar A.A për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit, nga neni 358, par. 1, të KP-së, te cilin gjatë seancës se shqyrtimit gjyqësor e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Mehreme Hoxha, e cila ne tërësi ngel pranë te dhënave si ne aktakuze, qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit.

I akuzuari si ne fjalën hyrëse po ashtu edhe ne fjalën përfundimtare nuk e ka pranuar fajësinë dhe nuk ka deklaruar diçka tjetër.

Gjykata si fakt vendimtar për fajësinë e të akuzuarit e ka marrë për bazë dëshminë e dëshmitarit rojtarit të pyllit A.T te dhënë në shqyrtim gjyqësor, i cili nder tjera ka deklaruar se ne ditën kritike e ka pare këtu te akuzuarin A.A duke pre dru ne pyllin publik me motorë sharre. Gjykata ia jep besimin e plote dëshmitarit ne fjale sepse nga marrja ne pyetje e dëshmitarit vërtetohet se i akuzuari ne ditën kritike ka qene duke pre dru me motor sharre dhe se rojtari i pyjeve e ka hasur te njëjtin ne mal.

Gjykata vlerëson se nga marrja ne pyetje e te akuzuarit është vërtetuar tërthorazi fajësia e te akuzuarit sepse i njëjti edhe vet e ka pranuar se jeton shume afër malit tek i cili dyshohet se i ka prerë drurët andaj edhe ky fakt vendimtar ka ndikuar ne bindjen e lire te gjykatës për ta ngarkuar me fajësi te njëjtin.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te vjedhjes se pyllit nga neni 358 par.1 te Kodit penal, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-së, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ndërsa gjatë shqiptimit të dënimit gjykata pati parasysh qellimin e dënimit qe te njejtis mos ti shkaktohet vujtje por i njejtis te risocializohet.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së.
Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 par. 1 te KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE

G j y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.